



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**DRAFT X
VERSION X**

30 QERSHOR 2014

**VENDIM
Nr. ____, datë _____ 2014**

“PËR PERCAKTIMIN E TARIFAVE VJETORE PËR LEJET E MJEDISIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave vjetore për lejet e mjedisit.
2. Operatorët do të paguajnë në llogari të Ministrisë së Mjedisit tarifat vjetore si më poshtë për:
 - a. instalimet e tipit A, në shumën prej 225 000 (dyqind e njëzetë e pesë mijë) lekësh;
 - b. instalimet e tipit B, në shumën prej 120 000 (një qind e njëzetë mijë) lekësh.
3. Tarifa derdhet nga operatorët në llogarinë bankare të Ministrisë së Mjedisit.
4. Të ardhurat nga tarifat e mësipërme do të shkojnë për Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inpektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA